



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 3872 Prot

Lezhë, më 30 / 03 /2026

VENDIM

Nr. 27, Datë 26. 03. 2026

**PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË PLOTË TË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT  
TË PËRCAKTUAR ME VKB NR. 93, DATË 30.10.2025, PËR 49 (DYZET E NËNTË)  
FAMILJE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 30 dhe nenit 42, pika 1, shkronja "b" dhe "d", të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", të ndryshuar, Aktit Normativ nr. 8, datë 07.12.2019 "Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qerasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019, i ndryshuar me Aktin normativ nr. 37, datë 24.12.2020 "Për një ndryshim në aktin normativ nr. 8, datë 07.12.2019 të Këshillit të Ministrave", VKB nr. 93, datë 30.10.2025 "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025", VKB nr. 115, datë 26.08.2020 "Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate), me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë", VKB nr. 141, datë 14.10.2020 "Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate), me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë", VKB nr. 17, datë 03.02.2021 "Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate), me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë", VKB nr. 27, datë 23.03.2022 "Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate), me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë", VKB nr. 76, datë 06.07.2022 "Për miratimin e listave të subjekteve ankues të cilëve iu pranua ankesa nga komisioni i ankimit për kategoritë DS4-DS5

të cilat kanë analizë të thelluar nga Instituti i Ndërtimit”, VKB nr. 112, datë 11.12.2019 “Për ndryshime të VKB-së nr.111, datë 06.12.2019 “Për miratimin e pagesës së plotë të qirasë sipas vlerës së tregut për familjet që janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

#### VENDOSI :

1. Miratimin e pagesës së plotë të qirasë, deri në momentin që familjeve t`u rindërtohen banesat, sipas VKB nr. 93, datë 30.10.2025, për familje, banesat e të cilave janë dëmtuar si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, sipas Lidhjes nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Afati i pagesës së qirasë mujore për familjet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, fillon nga muaji Janar 2026.
3. Familjet përfituese sipas këtij vendimi, përjashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës në masën e parashikuar nga ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.
4. Efektet financiare sipas këtij vendimi do të përballohen nga Fondi i Emergjencave Civile parashikuar në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2026.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI  
NDUE LULI

